

**DEGA NË SHQIPËRI E SHOQËRISË  
ERNST & YOUNG  
EKSPERTË KONTABËL TË AUTORIZUAR**

Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2018

**PËRMBAJTJA:**

<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>1</b>
<b>PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBYES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHPERFSHIRESE</b>	<b>2</b>
<b>PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL</b>	<b>4</b>
<b>1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM</b>	<b>5</b>
<b>2. POLITIKAT KONTABËL</b>	<b>5</b>
<b>3. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE</b>	<b>5</b>
<b>4. AKTIVET MONETARE</b>	<b>7</b>
<b>5. KLIENTË, AKTIVE TË ARKËTUESHME</b>	<b>8</b>
<b>6. TË TJERA AKTIVE AFATSHKURTRA TË ARKËTUESHME</b>	<b>8</b>
<b>7. PARAPAGIMI I TATIM FITIMIT</b>	<b>8</b>
<b>8. SHPENZIMET E SHTYRA DHE TË ARDHURAT E PËRLLOGARITURA</b>	<b>8</b>
<b>9. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE</b>	<b>9</b>
<b>10. FURNITORË DHE TË TJERA DETYRIME AFATSHKURTRA</b>	<b>10</b>
<b>11. SHPENZIMET E PËRLLOGARITURA DHE TË ARDHURAT E SHTYRA</b>	<b>10</b>
<b>12. HUA TË MARRA</b>	<b>10</b>
<b>13. KAPITALI DHE REZERVAT</b>	<b>10</b>
<b>14. TË ARDHURAT</b>	<b>11</b>
<b>15. KOSTO E PUNËS</b>	<b>11</b>
<b>16. SHPENZIME ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA</b>	<b>11</b>
<b>17. TË ARDHURA/(SHPENZIME) FINANCIARE</b>	<b>12</b>
<b>18. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN</b>	<b>12</b>
<b>19. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT</b>	<b>12</b>

## **RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

### **Për Aksionarët e Shoqërisë “DEGA NË SHQIPËRI E SHOQËRISË ERNST & YOUNG EKSPERTË KONTABËL TË AUTORIZUAR”**

#### **Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “DEGA NË SHQIPËRI E SHOQËRISË ERNST & YOUNG EKSPERTË KONTABËL TË AUTORIZUAR”(më poshtë “Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2018, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK-të”).

#### **Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA-të”). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël* (Kodi i “BSNEPK”) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.



## Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësinë kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

► Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.


► Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

► Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

► Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëriatë ndërpresë veprimtarinë.

► Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e "DEGA NË SHQIPËRI E SHOQËRISË ERNST & YOUNG EKSPERTË KONTABËL TË AUTORIZUAR", përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

  
Rezarta KOCOLLARI  
EKSPERTË KONTABËL  
Adresa: rr. Adem Seit Kruja, Nr.6/1, 1, 5.  
NIP: 121515021M  
Telefon: 0672009416

Tiranë, Shqipëri  
28 Qershor 2019




**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**  
**më 31 Dhjetor 2018**

AKTIVET	Shënime	31 dhjetor 2018 LEK	31 dhjetor 2017 LEK
Aktive monetare	4	5,665,774	5,922,535
Klientë, aktive të arkëtueshme	5	19,682,986	15,432,244
Të tjera aktive të arkëtueshme	6	15,051,750	17,315,288
Tatim fitimi i parapaguar	7	3,451,254	3,451,254
Të ardhura të përlogaritura dhe shpenzimet e shtyra	8	14,226,205	16,346,907
<b>Totali aktiveve afatshkurtra</b>		<b>58,077,969</b>	<b>58,468,227</b>
Aktive afatgjata materiale		6,975,893	8,059,497
Aktive afatgjata jomateriale		65,974	77,616
<b>Totali aktiveve afatgjata</b>	9	<b>7,041,868</b>	<b>8,137,113</b>
<b>TOTALI AKTIVEVE</b>		<b>65,119,837</b>	<b>66,605,340</b>
<b>Detyrimet dhe Kapitali</b>			
Furnitorë dhe të tjera detyrime afatshkurtra	10	57,991,854	117,546,203
Shpenzime të përlogaritura dhe të ardhura të shtyra	11	15,007,826	14,559,334
Hua	12	123,420,000	53,144,699
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>196,419,680</b>	<b>185,250,236</b>
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		16,865,643	16,865,643
Humbja e akumuluar		(148,175,486)	(135,520,539)
<b>Totali i kapitalit</b>	13	<b>(131,299,843)</b>	<b>(118,644,896)</b>
<b>TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>65,119,837</b>	<b>66,605,340</b>

Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri 12 janë firmosur dhe aprovuar më 29 Mars 2019 nga:

Hartuesi:

  
**Olta Hazapi Papadhopulli**  
 Financiere

Aprovuar:

  
**Mario Vangjel**  
 Administrator



**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA  
GJITHPERFSHIRESE**

**për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018**

	Shënime	<u>31 dhjetor 2018</u> LEK	<u>31 dhjetor 2017</u> LEK
<b>Të ardhurat</b>			
Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve		83,130,879	55,294,861
Të ardhura të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit		5,390,144	4,931,214
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>14</b>	<b><u>88,521,023</u></b>	<b><u>60,226,075</u></b>
<b>Shpenzime operative</b>			
Kosto e punës	15	(52,816,637)	(49,982,117)
Amortizimet dhe zhvlerësimet	9	(1,314,947)	(1,407,171)
Shpenzime administrative dhe të tjera	16	(54,353,712)	(28,852,692)
<b>Totali shpenzimeve</b>		<b><u>(108,485,296)</u></b>	<b><u>(80,241,980)</u></b>
<b>Humbja nga veprimtaritë kryesore</b>		<b><u>(19,964,273)</u></b>	<b><u>(20,015,905)</u></b>
Shpenzime interesi		(3,147,218)	(1,587,154)
Fitimet nga kursi këmbimit	17	10,456,543	6,716,292
<b>Humbja para tatimit</b>		<b><u>(12,654,948)</u></b>	<b><u>(14,886,767)</u></b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	18	-	-
<b>Humbja neto e vitit financiar</b>		<b><u>(12,654,948)</u></b>	<b><u>(14,886,767)</u></b>
<b>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b><u>(12,654,948)</u></b>	<b><u>(14,886,767)</u></b>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE**  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

	Shënime	31 dhjetor 2018 LEK	31 dhjetor 2017 LEK
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
Humbja përpara tatimit		(12,654,948)	(14,886,767)
Rregullime për:			
Amortizime dhe zhvlerësime	9	1,314,947	1,407,171
Provizjone për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme		321,380	1,122,404
Shpenzime për interesat dhe komisione		3,147,218	1,588,673
Efekti i kursit mbi aktivet e pasivet financiare afatgjata		(10,568,788)	(2,500,068)
<b>Fitimi nga veprimtaria e shfrytëzimit para rregullimeve në kapitalin punues</b>		<b>(2,497,068)</b>	<b>1,860,404</b>
Rritje në tepricën e kërkesave të arkëtueshme dhe aktiveve të tjera		(16,131,006)	(17,772,126)
Zvogelim në tepricën e detyrimeve për t'u paguar nga aktiviteti dhe detyrimeve të tjera		(59,105,857)	17,197,696
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>(77,733,931)</b>	<b>1,285,974</b>
Tatim mbi fitimin		-	-
Interes i paguar		-	-
<b>Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>(77,733,931)</b>	<b>1,285,974</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit</b>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	9	(219,700)	(2,734,694)
<b>Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e investimit</b>		<b>(219,700)</b>	<b>(2,734,694)</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e financimit</b>			
Hua të arkëtuarra		85,169,871	-
Pagesa e huave		(7,473,000)	-
<b>Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e financimit</b>		<b>77,696,871</b>	-
<b>Pakesimi neto i mjeteve monetare</b>		<b>(256,760)</b>	<b>(1,448,720)</b>
<b>Mjetet monetare në fillim të periudhës</b>	4	5,922,534	7,371,255
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	4	<b>5,665,774</b>	<b>5,922,534</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**  
**për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018**

	<b>Rezerva ligjore</b>	<b>Rezerva të tjera</b>	<b>Fitime të pashpërndara</b>	<b>Totali</b>
<b>Gjendja në 1 Janar 2017</b>	<b>10,000</b>	<b>16,865,643</b>	<b>(120,633,772)</b>	<b>(103,758,129)</b>
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit:</b>				
Humbja e vitit	-	-	(14,886,767)	(14,886,767)
<b>Totali i te ardhurat gjithëpërfshirëse te vitit:</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(14,886,767)</b>	<b>(14,886,767)</b>
<b>Pozicioni në 31 Dhjetor 2017</b>	<b>10,000</b>	<b>16,865,643</b>	<b>(135,520,539)</b>	<b>(118,644,896)</b>
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit:</b>				
Humbja e vitit	-	-	(12,654,948)	(12,654,948)
<b>Totali i te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit:</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(12,654,948)</b>	<b>(12,654,948)</b>
<b>Pozicioni në 31 Dhjetor 2018</b>	<b>10,000</b>	<b>16,865,643</b>	<b>(148,175,487)</b>	<b>(131,299,844)</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## **Dega në Shqipëri e Shoqërisë Ernst & Young EKA**

### **Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

*te gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe*

#### **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

Shoqëria Ernst & Young Ekspert Kontabël Të Autorizuar Shkup, dega Shqipëri është shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e krijuar më 12.01.2006 me numër regjistri tregtar 34715 e krijuar në përputhje me Ligjin “Për Shoqëritë Tregtare”.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është dhënia e shërbimeve të auditimit, konsulentë për taksat dhe shërbime kontabiliteti.

Administratori i shoqërisë është Z. Mario Vangjeli. Më 31 Dhjetor 2018 shoqëria kishte 21 punonjës (31 Dhjetor 2017: 24 punonjës).

Që prej datës 01 Nëntor 2014, selia qendrore e shoqërisë është në adresën “Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 6”, Tiranë. Ajo është regjistruar si person i tatuashëm në rrethin e Tiranës me numër identifikimi të personit të tatuashëm K619110121.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori më 29 Mars 2019.

#### **2. POLITIKAT KONTABËL**

Politikat kontabël janë organizuar bazuar në ligjin për “Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

#### **3. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

##### **a. Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të aplikueshme për pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat duke filluar nga 1 Janar 2018.

Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë të shprehura në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

##### **b. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

##### **c. Aktivitet afatgjatë materiale**

*(i) Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivitet afat-gjatë materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjatë materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.



# Dega në Shqipëri e Shoqërisë Ernst & Young EKA

## Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

te gjitha vlerat jane te shprehura ne Lek, pervec kur eshte shprehur ndryshe

### 3. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

#### c) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

(ii) *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Normat e amortizimit dhe metodat e përdorura janë si më poshtë:

<u>Kategoria</u>	<u>Metoda e amortizimit</u>	<u>Norma e amortizimit</u>
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyra dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Aktivitetet afatgjata jomateriale njihen atëherë kur është e mundur që të ketë përfitime ekonomike që do të sigurohen në të ardhmen në lidhje me këto aktive dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme.

#### d. Llogaritë e arkëtueshme dhe llogari të pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirës të financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### e. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat në Lek dhe në monedha të huaja. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat ose me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### f. Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.



**Dega në Shqipëri e Shoqërisë Ernst & Young EKA**  
**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

*te gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe*

**3. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)**

**f. Transaksione në monedhë të huaj (vazhdim)**

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet në lidhje me AAM për t'u blerë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj ishin si më poshtë (në Lek):

	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>31 Dhjetor 2017</u>
1 EUR	123,42	132,95
1 USD	107,82	111,10

**g. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do të vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

**h. Tatim fitimi**

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi për tatimin mbi fitimin. Tatimi mbi fitimin përfshin tërësisht tatimin mbi fitimin e llogaritur për periudhën kontabël. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 15% e fitimit të tatueshëm të përcaktuar në legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor në Shqipëri për vitin 2018 (2017: 15%).

**i. Biznesi në vijimësi**

Të dhënat e kontabilitetit janë mbajtur duke qenë në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, në mënyrë të veçantë me bazën e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhës, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit në vijimësi.

Pasqyrat financiare sipas legjislacionit janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecurisë normale të biznesit.

**4. AKTIVET MONETARE**

Aktivët monetare përbëhen nga Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe janë analizuar si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
	<u>LEK</u>	<u>LEK</u>
<b>Arka</b>	<b>47,946</b>	<b>424,884</b>
- në Lek	33,057	142,425
- në monedhë të huaj	14,889	282,459
<b>Llogari rrjedhëse</b>	<b>5,617,828</b>	<b>5,497,651</b>
- në Lek	978,875	3,502,824
- në monedhë të huaj	4,638,953	1,994,827
	<u><b>5,665,774</b></u>	<u><b>5,922,535</b></u>

**Dega në Shqipëri e Shoqërisë Ernst & Young EKA**  
**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**  
*te gjitha vlerat janë te shprehura ne Lek, pervec kur eshte shprehur ndryshe*

**5. KLIENTË, AKTIVE TË ARKËTUESHME**

Klientë, aktive të arkëtueshme përbëhen nga klientët te cilët janë detajuar si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
	<b>LEK</b>	<b>LEK</b>
Klientë vendas	26,912,360	22,496,427
Palë të lidhura	9,035,128	9,187,212
Provizione për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme	(16,264,502)	(16,251,395)
	<b>19,682,986</b>	<b>15,432,244</b>

**6. TË TJERA AKTIVE AFATSHKURTRA TË ARKËTUESHME**

Të tjera aktive të arkëtueshme përbëhen nga parapagimet për punonjësit dhe të tjera të drejta për tu arkëtuar.

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
	<b>LEK</b>	<b>LEK</b>
Parapagimet për punonjësit	-	467,647
Garanci te dhëna	32,898	
Të tjera të drejta për tu arkëtuar	15,018,852	16,847,641
	<b>15,051,750</b>	<b>17,315,288</b>

**7. PARAPAGIMI I TATIM FITIMIT**

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
	<b>LEK</b>	<b>LEK</b>
Parapaguar deri më 1 Janar	3,451,254	3,451,254
Tatim fitimi i vitit	-	-
Tatim fitimi i paguar gjatë vitit	-	-
	<b>3,451,254</b>	<b>3,451,254</b>

**8. SHPENZIMET E SHTYRA DHE TË ARDHURAT E PËRLLLOGARITURA**

Të ardhurat e përlllogaritura dhe shpenzimet e shtyra përfshijnë:

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
	<b>LEK</b>	<b>LEK</b>
Të ardhura të përlllogaritura	10,809,317	11,628,562
Shpenzime të periudhave të ardhshme	3,416,888	4,718,345
	<b>14,226,205</b>	<b>16,346,907</b>

Të ardhurat e përlllogaritura kanë të bëjnë me të ardhurat që lidhen me pjesën e shërbimeve të kryera gjatë 2018 por që janë faturuar në 2019 sipas kushteve të përcaktuara me klientin në kontratën e angazhimit.

Shpenzimet e shtyra (të periudhave të ardhshme) kanë të bëjnë me shpenzime të cilat i përkasin vitit 2019, por janë faturuar nga furnitorët në vitin 2018.

## Dega në Shqipëri e Shoqërisë Ernst & Young EKA

### Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

te gjitha vlerat janë te shprehura ne Lek, pervec kur eshte shprehur ndryshe

#### 9. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjatë janë analizuar si më poshtë:

	Mobilie dhe orendi	Pajisje zyre e informatike	Programe	Totali
<b>Aktivët me kosto</b>				
Gjendja më 1 Janar 2017	5,882,305	14,630,311	377,712	<b>20,890,328</b>
Shtesat	-	3,849,112	-	<b>3,849,112</b>
Pakësimet	(394,892)	(3,631,054)	(19,247)	<b>(4,045,193)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>5,487,413</b>	<b>14,848,369</b>	<b>358,465</b>	<b>20,694,247</b>
Gjendja më 1 Janar 2018	5,487,413	14,848,369	358,465	<b>20,694,247</b>
Shtesat	285,021	1,249,628	-	1,534,649
Pakësimet	(244,335)	(2,596,073)	-	(2,840,408)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>5,528,099</b>	<b>13,501,924</b>	<b>358,465</b>	<b>19,388,488</b>
<b>Amortizimi</b>				
Gjendja më 1 Janar 2017	3,928,047	9,866,293	286,399	<b>14,080,739</b>
Shtesat *	437,191	2,324,540	52,609	<b>2,814,340</b>
Pakësimet	(366,583)	(3,913,203)	(58,159)	<b>(4,337,945)</b>
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>3,998,655</b>	<b>8,277,630</b>	<b>280,849</b>	<b>12,557,134</b>
Gjendja më 1 Janar 2018	3,998,655	8,277,630	280,849	<b>12,557,134</b>
Shtesat*	359,197	2,259,055	11,642	<b>2,629,894</b>
Pakësimet	(244,335)	(2,596,073)	-	(2,840,408)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>4,113,517</b>	<b>7,940,612</b>	<b>292,491</b>	<b>12,346,620</b>
<b>Vlera e mbetur, 1 Janar 2017</b>	<b>1,954,258</b>	<b>4,764,019</b>	<b>91,313</b>	<b>6,809,590</b>
<b>Vlera e mbetur, 31 Dhjetor 2017</b>	<b>1,488,758</b>	<b>6,570,739</b>	<b>77,616</b>	<b>8,137,113</b>
<b>Vlera e mbetur, 31 Dhjetor 2018</b>	<b>1,414,582</b>	<b>5,561,312</b>	<b>65,974</b>	<b>7,041,868</b>

Nga totali i shpenzimeve vjetore të amortizimit për vitin 2018 prej 2,629,895 lek (2017: 2,814,340 lek), i janë alokuar 1,314,947 Lek kompanisë Ernst & Young Albania SHPK palë e lidhur, duke qënë se aktivët e kompanisë janë për përdorim të përbashkët.



## Dega në Shqipëri e Shoqërisë Ernst & Young EKA

### Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

te gjitha vlerat jane te shprehura ne Lek, pervec kur eshte shprehur ndryshe

#### 10. FURNITORË DHE TË TJERA DETYRIME AFATSHKURTRA

Të pagueshmet ndaj furnitorëve dhe të tjera detyrime afatshkurtra janë analizuar si më poshtë.

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
	<u>LEK</u>	<u>LEK</u>
Palë të lidhura	34,841,993	64,792,801
Hua afatshkurtra	20,341,842	48,768,711
TVSH për tu paguar	1,034,847	2,131,477
Furnitorë të tjerë	809,251	868,604
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	572,268	624,392
Tatimi mbi të ardhurat personale	335,969	360,218
Detyrime ndaj punonjësve	55,684	-
	<u>57,991,854</u>	<u>117,546,203</u>

#### 11. SHPENZIMET E PËRLLOGARITURA

Shpenzimet e përllogaritura përfshijnë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
	<u>LEK</u>	<u>LEK</u>
Shpenzime të përllogaritura	15,007,826	14,559,334
	<u>15,007,826</u>	<u>14,559,334</u>

Në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018 janë përfshirë shpenzime të përllogaritura të cilat lidhen me shërbime të furnizuara (të marra) gjatë vitit 2018, faturat për të cilat janë marrë gjatë vitit 2019. Sipas parimit të të ardhurave dhe detyrimeve të konstatuara këto shpenzime janë njohur në vitin fiskal të cilit i përkasin.

#### 12. HUA TË MARRA

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
	<u>LEK</u>	<u>LEK</u>
Hua	123,420,000	53,144,699
	<u>123,420,000</u>	<u>53,144,699</u>

Më datë 4 Maj 2015, kompania ka marrë një hua nga Ernst & Young Southeast Europe Business Advisory Services Limited (palë e lidhur), në vlerën 399,734 Eur me normë vjetore interesi O/N EURIBOR +3.35%. Më datë 17 Prill 2018, sipas një shtojce të kësaj kontrate huaja u rrit me vlerën 660,266 Eur nga të cilat në Nëntor 2018 u shlyen 60,000 Eur. Më datë 31 Dhjetor 2018 totali i huasë është 1,000,000 Eur ose ekuivalente në LEK 123,420,000 LEK. Afati i shlyerjes së huase është data 17 Prill 2020 me mundësi shtyrje të mëtejshme.

#### 13. KAPITALI DHE REZERVAT

Ernst & Young EKA dega në Shqipëri është dege e shoqërisë Ernst & Young Ekspertë Kontabël të Autorizuar Shkup shpk, dhe si e tillë nuk ka kapital aksioner.

Rezervat ligjore dhe rezervat e tjera janë mbajtur sipas statutit dhe ligjit për shoqëritë tregtare. Statuti parashikon krijimin e rezervës ligjore dhe krijimin e rezervave të tjera nga fitimet vjetore. Nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje, rezervat ligjore dhe rezervat e tjera nuk mund të ndryshojnë.

## Dega në Shqipëri e Shoqërisë Ernst & Young EKA

### Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

te gjitha vlerat jane te shprehura ne Lek, pervec kur eshte shprehur ndryshe

#### 14. TË ARDHURAT

Të ardhurat janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2018 LEK	31 dhjetor 2017 LEK
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	83,130,879	55,294,861
Të ardhura të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit	5,390,144	4,931,214
	<b>88,521,023</b>	<b>60,226,075</b>

#### 15. KOSTO E PUNËS

Kosto e punës është analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2018 LEK	31 dhjetor 2017 LEK
Paga dhe shpërblime	48,294,685	45,903,845
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	4,521,952	4,078,272
	<b>52,816,637</b>	<b>49,982,117</b>

#### 16. SHPENZIME ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

	31 dhjetor 2018 LEK	31 dhjetor 2017 LEK
Shpenzime konsulence financiare dhe ligjore	17,905,568	934,699
Shpenzime për licencë teknologjike	14,126,332	7,849,432
Të tjera shpenzime	6,829,161	3,536,835
Shpenzime qiraje	4,633,762	4,860,236
Trajnime profesionale	3,030,168	2,385,835
Shpenzime për udhëtime e dieta	2,415,829	3,286,559
Shpenzime postare e telekomunikacioni	1,968,498	1,894,050
Shpenzime siguracioni	1,604,192	1,601,707
Shpenzime abonimi	1,040,250	708,879
Kuotë anëtarësimi	665,230	399,155
Provigjone për borxhin e keq	321,380	1,122,404
Rrimarje e provigjoneve	(308,273)	-
Shpenzime për pritje përcjellje	121,615	272,902
	<b>54,353,712</b>	<b>28,852,693</b>

## Dega në Shqipëri e Shoqërisë Ernst & Young EKA

### Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

te gjitha vlerat jane te shprehura ne Lek, pervec kur eshte shprehur ndryshe

#### 17. TË ARDHURA/(SHPENZIME) FINANCIARE

Të ardhurat /(shpenzimet) financiare janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
	LEK	LEK
Fitime nga kurset e këmbimit	15,179,126	7,117,003
Humbje nga kurset e këmbimit	(4,722,583)	(399,192)
Shpenzime interesi	(3,147,218)	(1,588,673)
	<b>7,309,325</b>	<b>5,129,138</b>

#### 18. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2018 (2017: 15%).

Në vitin 2018 Shoqëria ka rezultuar me një humbje kontabël dhe humbje fiskale (2017: humbje kontabël dhe humbje fiskale) si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
	LEK	LEK
<b>1 Fitim / (humbja) para tatimit</b>	<b>(12,654,948)</b>	<b>(14,886,767)</b>
<b>2 Zëra shpenzimesh të panjohura/(te ardhura te pa-tatueshme), neto:</b>	<b>4,613,006</b>	<b>4,715,340</b>
<b>3 Fitimi / (humbja) fiskale (1+2)</b>	<b>(8,041,942)</b>	<b>(10,171,428)</b>
<b>4 (Humbje) të mbartura</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>5 Norma e tatimit mbi fitimin</b>	<b>15%</b>	<b>15%</b>
<b>6 Shpenzim tatim fitimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

#### 19. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të ishte e nevojshme të paraqitshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.